



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 2919/11 Prot

Tiranë, më 14/10/2021

Lënda: Njoftim

**DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE MË PUBLIKUN
KËTU
DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT
DHE AFTËSIVE TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 34, datë 14.09.2020 “Për mënyrën e emërimit dhe të liritimit nga detyra të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës” i ndryshuar, shkresës nr.2919/1 prot, datë 13.09.2021 “Njoftim për vend të lirë pune” të AKPA-s dhe Vendimit të Komisionit të Vlerësimit nr.2919/8 prot, datë 06.10.2021, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton emërimin e kandidatit si më poshtë:

Emërimin në detyrë të z.Artur Truka, në pozicionin e punës, Specialist në Sektorin e Menaxhimit e Ofrimit të Shërbimeve të Punësimit, Zona 3, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë, kategoria IV-b.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike të zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ

